

**SHTOJCA 4/f**

**Kriteret minimale - Resort**

<b>Tabela e mëposhtme është tabelë plotësuese që i bashkangjitet kriterëve minimale të kategorisë Hotel</b>		
<b>Fusha</b>	<b>Nr.</b>	<b>Kriteret</b>
Të përgjithshme	1	Ndërtesat duhet të jenë të shkëputura nga njëra tjetra.
	2	Vendndodhja e resortit është në një mjedis të qetë, të shkëputur nga qyteti.
	3	Hartë orientuese e resortit në hyrje të tij
	4	Sinjalistikë orientuese e detajuar dhe e mirëmbajtur për secilën nga godinat e resortit të pajisura me emër ose numër të veçantë
	5	Sigurimi i hapësirave të mëdha të hapura me gjelbërim
	6	Ofrimi i jo më pak se dy vakteve në ambientet e restorantit
	7	Kënd informacioni për veprimtaritë argëtuese të organizuara nga resorti (p.sh. eskursionet etj)
Pamja e jashtme	8	Infrastruktura e lëvizjes (rrugët/rrugicat) në resort të jetë lehtësisht e përkueshme dhe në gjendje të mirë.
	9	Gjendja e ndërtesave të jetë e qëndrueshme, e sigurtë dhe e mirëmbajtur. Të gjitha mekanizmat dhe pajisjet që ofrohen të jenë funksionale dhe të padëmtuara.
	10	Ndriçimi i ambientit të jashtëm në gjendje pune dhe në kushte të mira
Mirëmbajtja dhe sigurimi	11	Pastrim i rregullt dhe mjedisi i mirëmbajtur: pa mbeturina, gjethe etj
	12	Shërbim i mbikqyrjes së vazhdueshme të resortit turistik në tërësi.
	13	Facilitete të ndihmës së parë (i nevojshëm stafi i trajnuar).
Zona e pishinës	14	Pishinë e hapur, pishinë për fëmijë
	15	Shezlonge në zonën e pishinës
	16	Tualet dhe dush në zonën e pishinës
	17	Ofrimi i shërbimit të barit në zonën e pishinës
Shërbime të ofruara në resort	18	Ofrimi i 4 programeve të ndryshme argëtimi/animacion/sportive/mjedisore (1)

(1) Programe që mund të ofrohen nga resorti përfshijnë aktivitete tenisi, basketbolli, volejboli, ping-pongu, ski, kanoe, barbeque, koncerte, karaoke, diskotekë, bibliotekë, kënd lojrash për fëmijë, lojra për familjen dhe fëmijët, si puzzle, tavëll, domino, etj., aktivitete në pishinë, ofrim i pajisjeve sportive si biçikletë etj.